



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI I LËNDËS:
Kulturë digjitale dhe medie

Ngarkesa: 4kredite : 40 orë; 20 leksione /20 seminare

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti i tretë: Semestri i dytë

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme lëndore: Lënda synon të ndërgjegjësojë studentët për çështjet që lidhen me kulturën digjitale dhe median, si dhe t'i njohë ata me mjetet dhe aftësitë e nevojshme për të punuar, kërkuar dhe evoluar në një mjedis digjital.

Objektiva specifike lëndore:

- Të pajisen me bazat e kulturës dixhitale, me konceptet kyçe që lidhen me kulturën dixhitale si teknologjia dixhitale, interneti, rrjetet sociale, siguria kibernetike, etj.
- Të fitojnë vetëdije kritike mediatike dhe të jenë në gjendje të analizojnë në mënyrë kritike përmbajtjen e medias, të kuptojnë synimet dhe motivimet e mundshme të burimeve të lajmeve dhe të tregojnë maturi në konsumin e medias.
- Të zhvillojnë aftësi për kërkimin e informacionit. Studentët duhet të mësojnë të gjejnë, vlerësojnë dhe përdorin në mënyrë efektive informacionin në internet. Kjo përfshin aftësinë për të identifikuar burime të besueshme, për të verifikuar saktësinë e informacionit dhe për të shmangur dezinformimin.

Rezultate të pritshme:

Në përfundim të këtij moduli studentët :

- Do të zhvillojnë një ndërgjegje dhe njohuri të përgjithshme rreth mjedisit dhe teknologjisë digjitale, duke u bërë më të sigurt dhe efektivë në përdorimin e tyre
- Do të identifikojnë, vlerësojnë dhe përdorin informacionin në mënyrë të ndërgjegjshme dhe kritike nëpërmjet mjeteve dhe burimeve digjitale.
- Do të njohin rrezikun dhe sfidat e sigurisë në internet dhe do të fitojnë aftësi për të mbrojtur veten dhe të tjerët nga kërcënime të tilla si mashtrimi, vjedhja e identitetit, etje